

Burimet: deklarata N.S, FDH-30773; ICTY, IT-04-84 (R. Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 3.04.2008, FDH-27349.

Elver (Avdi) Mustafaj

(5.10.1978, rom nga Krusheva e Madhe/Veliko Kruševo, komuna e Klinës/Klina)

Në datën e pacaktuar të muajit maj 1998, Elveri ka shkuar te axha Bajram, i cili jetonte në fshatin fqinj të **Kralanit/Kraljane**. Pas disa ditësh, te shtëpia e Bajramit kanë ardhur tre shqiptarë, komshinj të tij [identiteti i tyre i njohur për FDH] dhe e kanë marrë Elverin. Nga ajo ditë, Elverit i është humbur çdo gjurmë. Zhdukja e tij është eidentuar nga KNKK-ja dhe lënda e tij e mban numrin rendor BLG-803330-01.

Burimet: deklarata A.M, FDH-23501; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Hajdar (Asman) Morina

(3.07.1939, shqiptar nga Morina, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, pesë fëmijë)

Në datën **3.05.1998**, Hajdari me vëllain Arifi u nisën për të dërguar me veturë komshiun Hysen Bajraktarin te mjeku Asllani në fshatin e Brovinës/Brovina. Automobilin e ngiste Arifi, ndërsa Hajdari ishte i ulur në ulësen e prapme. Me ta u nisën motra e tyre Drita dhe bashkëshorti i saj Sokoli, që i përcillnin me një makinë tjetër. Në afërsi të bjeshkës *Maja e Pllanikut/Planinski vrh*, Arifi dhe Hajdari përnjëherë vërejtën se Sokoli e ktheu mbrapa makinën e tij e tij dhe se po kthehej në drejtim të **Morinës/Morina**. I bindur se diçka nuk ishte në rregull, Arifi, po ashtu, deshi ta kthente makinën mbrapa, por nga bjeshka shtënenë mbi ta. Një plumb e ka qëlluar Hajdarin në kokë. Por, Arifi nuk e ndali makinën. Vazhdoi ta ngiste atë deri te shtëpia. Hajdari ende po merrte frymë kur e futën brenda. Nderroi jetë pas dy orësh. Për shkak të shtënave të njëpasnjëshme, familjarët arritën që ta varrosnin atë vetëm më 6.05.1998, në oborrin e shtëpisë së Arifit. Pas përfundimit të luftës, më 4.09.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Hajdarit në varrezat

familjare në Morinë/Morina.

Burimet: deklarata A.M, FDH-36756; KMDLNJ, *Buletini*, num.7, prill-qershor 1998, 121, FDH-23816.

Ramë (Ali) Neziraj

(1910, shqiptar nga Ponosheci/Ponoševac, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, i ve)

Që nga vdekja e bashkëshortes në vitin 1952, Rama i moshëthyer jetonte me vëllezërit Rrustemin dhe Sadriun dhe familjet e tyre. Shtëpia e tyre në **Ponoshec/Ponoševac** gjendej afro 20 metra larg nga stacioni lokal policor. Nga fillimi i muajit maj 1998, një pjesë e familjes e ka braktisur fshatin. Në shtëpi kanë mbetur Rama, Rrustemi dhe Sadriu me bashkëshorten Dyken. Në datën **3.05.1998**, nga ora 10:00, një gjyle ka rënë në afërsi të shtëpisë. Në ato çaste, Rama ishte duke ndenjur në oborr me Rrustemin. Pak pas, ushtarët serbë me një tank e kanë rrënuar derën e oborrit dhe kanë hyrë brenda. Rama u çua në këmbë. Duke i mallkuar, ai me një shkop, në të cilin u mbështeste, u nis në drejtim të ushtarëve. Ata reagan, shtënenë në drejtim të tij dhe e qëlluan për vde-kje. Pastaj, trupin e tij e kanë futur në një autobлиндë dhe e kanë çuar në morgun e Gjakovës/Đakovica. Dy ditë më vonë, familjarët kanë mësuar se trupi i Ramës ishte dërguar në Prishtinë/Priština. Pas pagesës prej 500 markash gjermane punëtorëve të Ndërmarrjes Komunale Publike *Çabrat/Čabrat*, kufoma e Ramës është kthyer në Gjakovë/Đakovica. Ai u varros në varrezat e këtij qyteti.

Burimet: deklarata S.N, FDH-29580; KMDLNJ, *Buletini*, num.7, prill-qershor 1998, 124, FDH-23816.

Avdyl (Islam) Duçi

(6.04.1937, shqiptar nga Ponosheci/Ponoševac, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Që nga viti 1993, numri i policëve serb në Ponoshec/Ponoševac ishte rritur. Në fillim të vitit 1997, situata u vështirësua edhe me arritjen e rezervistëve. Pozitat i kishin zënë në bjeshkën e *Pllanikut/Planik*. Komandanti i stacionit policor Dragutini,